



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1540/2 prot.

Datë 05.07.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-64132-03-29-2023 me objekt: “Blerje Letër A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK  
Autostrata Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore  
Tirane “Rruga e Kavajës” Nd.203 H.1, 1023, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Marketing & Distribution” SHPK  
Autostrada Tirane - Durres, Km.10, Kashar, Tiranë

Në datën 03.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3229, si dhe nr. protokollit 1540/2023 datë 04.07.2023 i operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-64132-03-29-2023 me objekt: “Blerje Letër A4”, me fond limit 2,470,833.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe e Tarifave Vendore Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat, operatori ekonomik ankimes “InfoSoft Office” SHPK, me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3229, si dhe nr. protokollit 1540/2023 datë 04.07.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

- Në Shtojcën 5 (Formulari i Specifikimeve Teknike) janë përcaktuar specifikimet teknike për mallin objekt prokurimi si më poshtë:

#### **Letër format A4:**

- Përmasat e letrës të jenë 210x297 mm;
  - 1 (një) rizëm të përmbajë 500 (pesëqind) fletë A4;
  - Letra të jetë ngjyrë e bardhë absolute në mënyrë që të ketë kontrast në printim dhe në fotokopjim;
  - Pesha e një flete A4 të jetë 80 gram/m<sup>2</sup>;
  - Cilësi “anti-curl” që redukton bllokimet e letrës në paisje;
  - Sipërfaqe e lëmuar;
  - Përdorimi: Për printim dhe fotokopjim;
  - Dukshmëria: >94%
  - Shkëlqimi: nga 95 deri në 110%;
  - Letra të qëndrojë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit;
  - Të jetë e përshtatshme për printim nga të dyja krahët e letrës;
  - Të plotësojë standardet që letra të mbahet për një periudhë kohore jo më pak se 5 vjet në arkivë;
  - Të mos jetë letër e ricikluar;
  - Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës në kuti me kapacitet 5 (pesë) rizma;
- Në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, tek 2 Kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik është kërkuar:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë AK katalogë/ skeda teknike nën autoritetin e prodhuesit. (Katalogjet ose skedat teknike të marra nga publikimi në faqet zyrtare/ ëbsite të prodhuesve do të konsiderohen origjinale nga AK)

Dokumentacioni i kërkuar në këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Gjithashtu katalogët/ skeda teknike të përmbajë **ISO 9706:2002**.

*Shënim ; Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 05.07.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**